



MANUAL PËR REFORMËN NË DREJTËSI



2021

Nga seritë e Edukimit Politik për të rinjtë/KRK/HSS Udhëzues/Doracak/2/2021

Kongresi Rinor Kombëtar është një organizatë ombrellë që ka si qëllim mobilizimin e organizatave rinore dhe fuqëzimin e rolit të të rinjve në shoqëri. Nëpërmjet Kongresit Rinor Kombëtar të rinjtë në të gjithë Shqipërinë kanë një zë të përbashkët për të adresuar, advokuar dhe lobuar për çështjet që prekin rininë.

Autorë:

Marsela Sako
Dafina Peci

©2021 nga
Kongresi Rinor Kombëtar
Address: Rr. Abdyl Frashëri, Pall. 11, Shkalla 5, Kati 3, Ap. 40
Tiranë – Shqipëri
Info@krk.al


Ky botim u realizua me mbështetjen e Fondacionit Gjerman Hanns Seidel. Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë punim janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Gjerman Hanns-Seidel. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë ose të përpunohet, shumëfishohet dhe shpërndahet duke përdorur sistemet elektronike, pa lejen me shkrim të Kongresit Rinor Kombëtar dhe Fondacionit Gjerman Hanns-Seidel, përveç rasteve kur një veprim i tillë është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të drejtat e autorit. Përdorimi komercial i këtij publikimi nuk është i lejuar.

Reforma në Drejtësi

Hyrje

Përkufizimi i termave¹

- **Termi “Gjyqtar”** nënkupton çdo person që shërben si gjyqtar në çdo gjykatë të shkallës së parë, gjykatë apeli, Gjykatë të Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatë të Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjykatë administrative, Gjykata e Apelit Administrative apo Gjykatën e Lartë, Gjykatë Kushtetuese
- **Termi “Prokuror”** nënkupton çdo prokuror në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës të parë, në prokuroritë pranë gjykatave të apeleve, në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe në Prokurorinë e Përgjithshme
- **Termi “Prokuror më i lartë”** është titullari/drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
- **Termi “Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”** përdoret për t’iu referuar Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar quhet shkurtimisht “SPAK”.
- **Termi “Njësisë së Posaçme Hetimore, e cila emërtohet “Byroja Kombëtare e Hetimit”** shkurtimisht “BKH”.



¹Ligji nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” Neni 3,3 5 6 7

Konteksti i nisjes së reformës në drejtësi

Përmbysja e sistemit totalitar në Shqipëri, si një nga sistemet më të egra të implementuara në vendet e bllokut lindor, e vuri elitën politike shqiptare përballë sfidash të shumta. Një nga sfidat ishte përshtatja e sistemit kushtetues që pas përpjekjeve të shumta arriti të miratohej me referendum në vitin 1998. Amendamentet e para në këtë kushtetutë u realizuan në vitin 2008, ndërhyrje të cilat në fakt prishën sistemin e balancave dhe kontrolleve reciproke.

Reformimi i sistemit të drejtësisë konsiderohet si një nga reformat më thelbësore të ndërmarra që nga viti 1990, në funksion të forcimit dhe konsolidimit të shtetit të së drejtës në Shqipëri.

Dinamika e zhvillimit të shoqërisë në aspektin ekonomik dhe shoqëror, si dhe problematikat e shfaqura brenda sistemit, kanë sjellë si prioritet kyç nevojën për përshtatje të legjislacionit të institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë me pritshmërinë e shoqërisë shqiptare kryesisht në elemente të tilla që ndikojnë në rritjen e integritetit të sistemit, në pavarësinë, efikasitetin, besueshmërinë, transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e tij. Korrupsioni, keqfunksionimi, mungesa e integritetit, profesionalizmit, pavarësisë, efikasitetit, besueshmërisë, transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së sistemit tashmë janë identifikuar dhe pranohen gjerësisht si fenomene dëmtoese, që duhet të jenë në fokus të kësaj reforme të thellë, me qëllim ndryshimin e situatës në sistemin e drejtësisë në vend.²

Në funksion të përmblyshjes së këtyre synimeve në vitin 2014, Kuvendi miratoi ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë.³ Komisioni i Posaçëm përbëhej nga 10 anëtarë, nga të cilët 5 përfaqësues të shumicës parlamentare (4 PS dhe 1 LSI) dhe 5 të pakicës parlamentare (4 PD e 1 PR).

Objekti kryesor i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm ishte:

- Analizimi i gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë, me qëllim evidentimin e problematikave dhe nevojave për përmirësim, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, dhe diskutim gjithëpërfshirës me institucionet e sistemit të drejtësisë, ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, subjektet e tjera të interesuara dhe opinionin publik.
- Hartimi i një dokumenti strategjik për objektivat e reformës në sistemin e drejtësisë, bazuar në analizën e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë.
- Propozimi për miratim i një pakete të plotë projektligjesh të nevojshme për reformimin e legjislacionit, që rregullonte organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë ato kushtetuese, e hartuar me kontributin dhe mbështetjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, subjekteve të tjera të interesuara dhe opinionit publik

² <http://www.reformanedrejttesi.al/pse-nje-reforme-ne-drejttesi>

³ VENDIM I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Nr. 96/2014

Kështu, pas një pune intensive të Komisionit të Posaçëm, në 22 korrikut 2016, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi me unanimitet te plotë 140 vota pro, reformën më radikale, e cila i hapi rrugën ndryshimeve kushtetuese (u mundësuan ndryshimet në 46 nene të Kushtetutës si dhe u krijua hapësira ligjore për miratimin e shumë ligjeve të tjera në funksion të organizimit dhe funksionimit të reformës në drejtësi). Një rol të padiskutueshëm në këtë proces kanë luajtur partnerët kryesorë të Shqipërisë përkatësisht SHBA dhe BE si dhe përfshirja e ekspertëve më të mirë ndërkombëtarë (Komisionit Europian (Misioni EURALIUS), të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID/OPDAT), të Këshillit të Europës (Komisioni i Venecias), të Prezencës së OSBE-së dhe të misioneve të asistencës për çështjet e drejtësisë të përfaqësive diplomatike në Tiranë), sikundër dhe ekspertëve shqiptarë nga institucionet e sistemit dhe institucionet e pavarura

I gjithë procesi ka përfshirur tre faza:⁴

- 1) vlerësimin e situatës në sistemin e drejtësisë;
- 2) ndërtimin e strategjisë dhe përcaktimin e objektivave;
- 3) përgatitjen e ndryshimeve përkatëse kushtetuese dhe ligjore.



Si rezultat i kësaj reforme të thellë të gjitha aspektet e organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë u shndërruan thelbësisht. Ndërhyrjet kryesore përfshijnë: (i) Reduktimin e kompetencave të Presidentit të Republikës në çështjet e drejtësisë; (ii) Reduktimin e kompetencave të Ministrit të Drejtësisë në çështjet e drejtësisë; (iii) Rikonceptimin e mënyrës së emërimit dhe përgjegjshmërisë së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë; (iv) Zgjerimin e rolit të Gjykatës Kushtetuese në mbrojtje të të drejtave të njeriut; (v) Reduktimin e rolit të Gjykatës së Lartë në një gjykatë që punon kryesisht përmes krijimit të precedentëve; (vi) Forcimin e vetëqeverisjes së gjyqësorit përmes forcimit të statusit të gjyqtarëve dhe zgjerimit të kompetencave të Këshillit të Lartë Gjyqësor; (vii) Rikonceptimin e sistemit dhe të procedurave disiplinore ndaj magjistratëve; (viii) Krijimin e kushteve për avancimin e meritokracisë në karrierat e magjistratëve; (ix) Decentralizimin e sistemit të prokurorisë dhe rikonceptimin e qeverisjes së sistemit të prokurorisë; (x) Prezantimin e strukturave të posaçme për hetimin dhe gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe; (xi) Prezantimin e një sistemi të përkohshëm e të jashtëzakonshëm për verifikimin e integritetit dhe profesionalizmit të magjistratëve (vetting-u).⁵

Në vijim të synimit të përgjithshëm të reformës të shpjeguar më sipër, kjo strategji ndjek disa synime specifike për reformimin e sistemit të drejtësisë për ta bërë atë⁶ :

- të pavarur ndaj çdo lloj ndikimi;
- të paanshëm në funksionimin e tij;

⁴Kuvendi i Republikës së Shqipërisë REFORMA NË SISTEMIN E DREJTËSISË: ANALIZA DHE STRATEGJIA, VËLLIMI I 2017

⁵Mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë (2016) – Instituti për studimet Publike dhe Ligjore <http://ipls.org/wp-content/uploads/2020/07/Komentar-Mbi-reformen-kushtetuese-final.pdf>

⁶Strategjia e reformës në sistemin e drejtësisë, Republika e Shqipërisë Kuvendi, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë Projekt 24 korrik 2015

- të përgjegjshëm, llogaridhënës, me integritet të lartë moral dhe profesional në të gjitha nivelet strukturore të tij;
- efiçient dhe profesional;
- të besueshëm, transparent dhe i aksesueshëm prej publikut;
- bashkëpunues në nivel institucional kur ushtrohet pushteti vendimmarrës për emërimin e funksionarëve të lartë të sistemit.

Kështu, sfidat kryesore të reformës në drejtësi nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese lidheshin me ndryshimet në sistemin e gjykatave dhe atë të prokurorisë. Qëllimi kryesor mbetet riorganizimi i këtyre organeve në përputhje me standartet europiane, ndërtimin e strukturave të reja dhe sigurisht me procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Ndryshimet kushtetuese kanë kaluar edhe në filtrin e Komisionit të Venecias, i cili me rekomandimet e tij ka kontribuar në përmirësimin e shumë dispozitave kushtetuese.

Në Opinionin e tij Përfundimtar për projektin e amendamenteve kushtetuese të reformës në drejtësi Komisioni i Venecias thekson, se:

“52. Në lidhje me masat e jashtëzakonshme për të ri-vlerësuar gjyqtarët dhe prokurorët,

Komisioni i Venecias vijon të mbetet i mendimit që këto masa jo vetëm që janë të justifikuar, por janë të nevojshme që Shqipëria të mbrohet nga korrupsioni, i cili, nëse nuk adresohet, mund të shkatërrojë plotësisht sistemin gjyqësor.

53. Projekt amendamentet kushtetuese të rishikuara marrin parasysh kritikën që ka bërë Komisioni në Opinionin e Ndërmjetëm. Varianti i ri i Aneksit është shkruar në mënyrë më të saktë dhe shumica e sugjerimeve të Komisionit të Venecias janë marrë parasysh. E gjithë skema është më e qartë dhe jep garanci më të mira për individët që mund të preken nga vettingu”.

Megjthatë, pavarësisht se Komisioni i Venecias ka nënvizuar domosdoshmërinë dhe rëndësinë e këtij procesi në një situatë të jashtëzakonshme, por edhe tranzitore, sikurse ishte vendi ynë, gjithashtu vlen të evidentohet edhe qëndrimi i mbajtur nga ky Komision në draftin e Opinionit të Ndërmjetëm që ka paraqitur në 4 Dhjetor të vitit 2015.

Konkretisht, në paragrafin 98 të këtij opinioni të ndërmjetëm, Komisioni i Venecias nënvizon, se:

“Duhet të kujtojmë se kjo zgjidhje kaq radikale (vettingu) nuk do të ishte e rekomandueshme në kushte të normalitetit, pasi krijon tension tepër të lartë në sistemin gjyqësor, destabilizim punën e tij, shton mosbesimin e publikut tek gjyqësori, shpërqëndron vëmendjen e gjyqtarëve nga detyrat e tyre normale, dhe, si një masë e jashtëzakonshme, krijon riskun e kapjes së gjyqësorit nga forca politike që kontrollon procesin”.

Vihet re se në Opinionin Përfundimtar të Komisionit të Venecias, pasi janë shprehur vlerësimet për procesin e vettingut si një masë e jashtëzakonshme dhe tranzitore për të luftuar korrupsionin në sistemin e drejtësisë, gjithashtu janë adresuar disa rezerva në paragrafët 54, 55 dhe 56 të këtij Opinioni.

Këto rezerva kanë të bëjnë me kohëzgjatjen apo mandatin e organeve të vettingut, duke vendosur theksin te fakti që në këtë proces nuk duhet të ketë vonesa, pasi në të kundërt, nga një masë e jashtëzakonshme dhe tranzitore mund të afektohet veprimtaria e organeve të reja të sistemit të drejtësisë, të cilat janë organe të përhershme.

Kjo rezervë e Komisionit të Venecias vlerësohet se është arsyeja përse në draftin përfundimtar të amendamenteve kushtetuese, të miratuara nga Kuvendi u parashikua një kohëzgjatje më e vogël e mandatit të anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik, përkatësisht 5 vjet nga data e fillimit të funksionimit të tyre, ndërsa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Apelit u parashikua 9 vjet, për shkak se shqyrtimi i ankimeve në këtë Kolegj do të vijonte në kohë edhe pas pushimit të ekzistencës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Në funksion të organizimit dhe funksionimit të institucioneve të reja që parashikoheshin nga ndryshimet Kushtetuese, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë mbi bazën e re Kushtetuese ka miratuar ligjet si më poshtë:

- 1) Ligji nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”;**
- 2) Ligji nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;**
- 3) Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”;**
- 4) Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;**
- 5) Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;**
- 6) “Ligji nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë””;**
- 7) Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”.**

Gjykatat

Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm janë gjykata me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë dhe gjykata me juridiksion të përgjithshëm të apelit.

Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë mund të kenë degë. Gjykata të posaçme janë: a) gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykata Administrative e Apelit; b) Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe e Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Gjykata e Lartë gjykon çështje të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm.⁷

⁷Ligji nr. 98/2016 Neni 3

Gjykata e Lartë

Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë qëndron në majën e e piramidës gjyqësore. Ajo siguron dhënien e barabartë dhe të paanshme të drejtësisë për të gjithë qytetarët në vend dhe vendos standardet e një gjykimi të drejtë. Gjykata e Lartë e ushtron pushtetin në përputhje me parashikimet Kushtetuese dhe ligjin. Në këtë kuptim ky organ i rëndësishëm e bazon veprimtarinë e tij mbi parimet themelore që janë: pavarësia, paanësia, efikasiteti, barazia, drejtësia, besueshmëria, llogaridhënia dhe aksesit transparent në drejtësi për të gjithë.

Si gjykata më e lartë në vend, Gjykata e Lartë mbulon të gjithë territorin e vendit. Selia e saj është në Tiranë. Ajo shqyrton rekurset kundër vendimeve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat e posaçme të shkallëve më të ulëta, me misionin e vetëm që të sigurojë unifikim dhe zhvillim të mëtejshëm të praktikës gjyqësore.

Gjykata e Lartë i ushtron funksionet gjyqësore përmes kolegjeve të saj.⁸

- *Kolegji Civil*, shqyrton rekurset kundër vendimeve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm për çështje tregtare, civile dhe familjare, si dhe për çështje të tjera, të përcaktuara në ligj.
- *Kolegji Penal*, shqyrton rekurset kundër vendimeve penale të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe nga gjykatat e posaçme për çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe për çështje të tjera, të përcaktuara në ligj.
- *Kolegji Administrativ*, shqyrton rekurset kundër vendimeve të gjykatave administrative. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë⁹ emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi. Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të rasteve kur Presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, sipas ligjit. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosëmërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kandidati shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

⁸ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Gjykata_4_1.php

⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ndryshuar, Neni 136

Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteria të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj.

Gjykata Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese ka një juridiksion të veçantë për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjerë normativë. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj (neni 124/1 i Kushtetutës). Gjatë ushtrimit të funksionit të saj ajo i nënshtrohet vetëm Kushtetutës (neni 124/2 i Kushtetutës).

Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë anëtarë, prej të cilëve tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet, me një të tretën e saj. Anëtarët e rinj caktohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës, nga Kuvendi dhe nga Gjykata e Lartë. Ky rregull ndiqet edhe në rastet e përfundimit para afatit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese¹⁰.

Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese janë të parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës, sipas të cilit ky organ vendos për¹¹ :

- a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në Nenin 122;
- b) pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre;
- c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;
- ç) mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;
- d) kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas Nenit 9 të kësaj Kushtetute;
- dh) shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij;
- e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre.”
- ë) kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;
- f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

¹⁰Ligji nr. 98/2016 Neni 7

¹¹Për më shumë shih: faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese http://www.gjk.gov.al/web/Historiku_97_1.php

Gjykatën Kushtetuese mund ta vënë në lëvizje¹² :

- a) Presidenti i Republikës;
- b) Kryeministri;
- c) jo më pak se një e pesta e deputetëve;
- ç) Avokati i Popullit;
- d) Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- dh) çdo gjykatë, sipas nenit 145, pika 2, të Kushtetutës;
- e) çdo komisioner i krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta;
- ë) Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- f) organet e qeverisjes vendore;
- g) organet e bashkësive fetare;
- gj) partitë politike;
- h) organizatat;
- i) individët.



Gjykata Kushtetuese, në rastin kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të miratuar nga Kuvendi sipas nenit 177, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.

Gjykata Kushtetuese gjithashtu vendos edhe mbi kushtetutshmërinë e:

- a) vendimit të Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës (neni 90/3, 91/2 i Kushtetutës);
- b) vendimit për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (neni 140/4 i Kushtetutës);
- c) vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin e kryetarëve të komunave ose bashkive (neni 115 i Kushtetutës);

Kërkesat që vijnë para Gjykatës Kushtetuese ndjekin këtë procedurë:

Kërkesa, pasi regjistrohet, i dorëzohet Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili merr masat për caktimin me short të relatorit të çështjes, sipas Rregullores së Gjykatës. Relatori ia paraqet çështjen kolegjit prej tre anëtarësh, në të cilin bën pjesë dhe ai. Kolegji vendos për pranueshmërinë e kërkesës, pra kalimin e saj në seancë plenare. Nëse kolegji nuk arrin të vendosë unanimisht, çështja i paraqitet mbledhjes së gjyqtarëve, që vendos me shumicë votash. Çështja nuk pranohet të kalojë në seancë kur objekti i saj nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, apo kur kërkuesi nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Seancat plenare zhvillohen të hapura dhe duke respektuar parimin e kontradiktoritetit, si dhe parimet e tjera themelore të gjykimit në përgjithësi dhe atij kushtetues në veçanti. Për rastet e interpretimit të Kushtetutës gjykimi mund të zhvillohet edhe vetëm mbi bazën e dokumentave

¹² Faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese. Shih: http://www.gjk.gov.al/web/Historiku_97_1.php

Palët mund të përfaqësohen me avokatë. Shpenzimet e procesit gjyqësor para Gjykatës Kushtetuese i nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifatat gjyqësore.

Në fund të çdo shqyrtimi gjyqësor Gjykata Kushtetuese shprehet me vendim.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese arsyetohen me shkrim dhe hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim (neni 132 i Kushtetutës). Si rregull, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë fuqi prapavepruese. Megjithatë ligji parashikon raste përjashtimore: vendimet që shfuqizojnë dënimet penale, qofshin këto edhe në fazën e ekzekutimit të tyre, vendimet që interpretojnë Kushtetutën, vendime që lidhen me pasoja ende të paezauruara të aktit normativ të shfuqizuar dhe ato lidhur me vendimet e gjykatave derisa këto të fundit nuk kanë marrë formë të prerë.

Prokuroria

Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit¹³. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

Përbëhet nga:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Prokuroria e Posaçme, sipas ligjit të posaçëm;
- c) prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- ç) prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimin të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme

Drejtimi dhe përfaqësimi i prokurorisë, bëhet, respektivisht, nga¹⁴:

- a) Prokurori i Përgjithshëm;
- b) Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme;
- c) drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;

¹³Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ndryshuar, Neni 148

¹⁴Faqja zyrtare e Prokurorisë së Përgjithshme <https://www.pp.gov.al/Organizimi/Organizimi/>

ç) drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca: a) përfaqëson akuzën në Gjykatën e Lartë dhe çështjet në Gjykatën Kushtetuese, me përjashtim të rastit kur përfaqësimi bëhet nga Prokuroria e Posaçme; b) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët, me përjashtim të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme; c) siguron mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë, me përjashtim të administratës së Prokurorisë së Posaçme. Krijimi dhe mbarëvajtja e strukturave të teknologjisë së informacionit në prokurori rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave; ç) propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë, me përjashtim të buxhetit të Prokurorisë së Posaçme; d) raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit; dh) ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara në ligj.¹⁵

Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë, që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit¹⁶.

Organet e reja të (ri)formuara në funksion të administrimit të drejtësisë

Ligji nr. 115/2016 "Për funksionimin dhe organizimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtë-sisë në Republikën e Shqipërisë" përcakton rregulla për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), katër organe kushtetuese të (ri)krijuar rishtazi, garante të një qeverisjeje të drejtë, të pavarur, transparente dhe të besueshme të sistemit të drejtësisë. Qëllimi i këtij ligji është mirëqeverisja e sistemit të drejtësisë në funksion të pavarësisë, përgjegjshmërisë, efikasitetit dhe transparencës së tij. Këto organe zëvendësojnë pjesërisht organet ekzistuese¹⁷.

Këshilli i Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësor një autoritet gjyqësor vetëqeverisës, që e mbron sistemin gjyqësor nga ekzekutivi dhe legjislativi. Ministri i Drejtësisë nuk do të jetë më anëtar i Këshillit. Gjithashtu, ai mund të marrë pjesë vetëm pa të drejtë vote në seancat e caktuara për diskutimin

¹⁵Ligji nr. 76/2016 Neni 148/b

¹⁶Ligji nr. 76/2016 Neni 148/ ç

¹⁷Reforma në Drejtësi, Modul Trajnimi për Student jo-juristë dhe Aktivistë të Shoqërisë Civile, Konrad Adenauer Stiftung 2018

e planifikimit strategjik dhe buxhetin. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbën një nga organet e reja të formuara me një rëndësi thelbësore. Formalisht ky organ zëvendësoi organin e mëparshëm KLD (Këshilli i Lartë i Drejtësisë), por sigurisht me ndryshimet kushtetuese KLGJ ndryshonte thelbësisht nga KLD si në aspektin e përbërjes ashtu edhe të kompetencave.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është organ kolegjal i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë, të cilët shërbejnë në detyrë me kohë të plotë. Gjashtë prej anëtarëve të Këshillit janë gjyqtarë nga të gjitha nivelet e pushtetit gjyqësor. Pesë anëtarët e tjerë të Këshillit janë juristë të përzgjedhur nga radhët e avokatëve, të pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë, të Shkollës së Magjistraturës dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile¹⁸.

Anëtarët gjyqtarë zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të të gjitha niveleve¹⁹ ndërsa anëtarët jogjyqtarë që zgjidhen nga radhët e avokatëve, trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe shoqërisë civile zgjidhen nga Kuvendi, bazuar në një proces vlerësimi paraprak të kushteve dhe kriterëve ligjore, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj²⁰. Përveç rasteve kur vërtetohen kushtet për ndërprerjen e parakohshme të mandatit, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor qëndron në detyrë për 5 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme²¹.

Vlen të theksojmë se zgjedhja e 6 anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor rezulton nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të të gjitha niveleve sipas raportit të mëposhtëm²²:

- a) tre prej të zgjedhurve janë gjyqtarë të shkallës së parë. Së paku 1 prej tyre është gjyqtar në një gjykatë të shkallës së parë jashtë Tiranës;
- b) dy prej të zgjedhurve janë gjyqtarë të apelit. Së paku 1 prej tyre është gjyqtar në një gjykatë të apelit jashtë Tiranës;
- c) një prej të zgjedhurve është gjyqtar në Gjykatën e Lartë.




¹⁸Ligjit Nr. 115/2016 Neni 3/1

¹⁹Ligjit Nr. 115/2016 Neni 3/2

²⁰Ligjit Nr. 115/2016 Neni 3/3

²¹Ligji Nr. 115/2016 Neni 3/4

²²Ligjit Nr. 115/2016 Neni 7/1



Shënime:

1. Vetëm ata gjyqtarë që plotësojnë kushtet ligjore mund të kandidojnë për KLGJ. Anëtarët gjyqtarë zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të të gjithë niveleve.
2. Vetëm ata avokatë, pedagogë dhe aktivistë të OJF-ve që plotësojnë kushtet ligjore mund të kandidojnë për KLGJ.
3. KLGJ është organi kryesor i qeverisjes së gjyqësorit, përgjegjës për çështjet e personelit dhe administrimit të gjykatave.
4. Komisionet ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve nga avokatia, shoqëria civile dhe nga trupa e pedagogëve, Dekanati i Fakulteteve të Drejtësisë dhe Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës zgjedhin kandidatët për anëtar të KLGJ.

Burimi: <https://www.njihreformenedrejttesi.al/sq/klgj/cfare-eshte-klgj>

Ajo që mund të konsiderohet risi është fakti që KLGJ është një organ që ka në përbërje të tij përveç gjyqtarëve dhe jo gjyqtarë dhe se në përbërje të tij nuk është Ministri i Drejtësisë. Duhet theksuar se Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor (Neni 147/a²³ i Kushtetutës).

Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Ngritja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë përcaktohet sipas nenit 149²⁴ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ky organ garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, nga radhët e juristëve joprokurorë.

²³Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016

²⁴Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016

Këshilli i Lartë i Prokurorisë²⁵ ushtron këto përgjegjësi: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve; b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve; c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit; ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre; d) propozon dhe administron buxhetin e tij; 16 dh) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë; e) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj. 2. Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.”

Anëtarët prokurorë përzgjidhen nga radhët e prokurorëve me integritet të lartë moral dhe profesional, sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të prokurorisë. Anëtarët joprokurorë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj.

Dy anëtarë joprokurorë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike, shpall vendet vakante, sipas ligjit.

Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit, anëtarët prokurorë kthehen në vendet e mëparshme të punës. Mandati i prokurorit të posaçëm pezullohet gjatë kohës që ushtron funksionin si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Anëtarët joprokurorë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barasvlershme me to.

Përsa i përket organizimit dhe funksionimit të tij, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ruan të njëjtën

strukturë si Këshilli i Lartë Gjyqësor. Pra, edhe ky institucion funksionon me përbërje të plotë si edhe me komisione të cilat kanë të njëjtën ndarje, strukturë dhe kompetenca si ato të Këshillit të Lartë Gjyqësor²⁶.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i cili në ligj përcaktohet si një organ i pavarur, përgjegjës për të verifikuar përmbushjen e kushteve ligjore dhe të kritereve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

²⁵Ligji nr. 76/2016 Neni 149/a

²⁶Monitorimi i Zbatimit të Reformës në Drejtësi Tiranë, 2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi²⁷ kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mbledhet sa herë është e nevojshme. Përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk është dhënë masë disiplinore. Ata ushtrojnë detyrën me mandat njëvjeçar, që fillon në datën një janar të çdo viti kalendarik. Presidenti i Republikës përzgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik, dy gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, një gjyqtar nga Gjykata e Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë nga gjykatat e apelit, si dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 5 dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 dhjetor të atij viti kalendarik. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është anëtari i Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë krijon kushtet e punës për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Kriteret e tjera për shkallën e kualifikimit të kandidatëve që marrin pjesë në short parashikohen me ligj. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rregullohet me ligj.“

Inspektorati i Lartë i Drejtësisë

Ky autoritet ka si objekt kryesor të punës së tij verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;

Inspektori i Lartë i Drejtësisë²⁸ zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. 4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga lista e pesë kandidatëve të përzgjedhur dhe renditur mbi bazën e meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas një procedure transparente dhe publike. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej tri të pestave për asnjë prej kandidatëve brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës, kandidati i renditur i pari shpallet i emëruar. 5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. 6. Procedura e vendimmarrjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë rregullohet me ligj. Ankimet ndaj vendimeve lidhur me masat disiplinore ndaj inspektorëve të tjerë shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

²⁷Ligji nr. 76/2016 Neni 149/d

²⁸Ligji nr. 76/2016 Neni 147/d

Në kuadrin e reformës në funksion të zbatimit të ndryshimeve kushtetuese janë miratuar ligje të reja të cilat rregullojnë organizimin e pushtetit gjyqësor, me qëllim forcimin e statusit të gjyqtarëve, të prokurorëve ose krijimin e institucioneve e qeverisjes së gjyqësorit.

SPAK

Në kuadër të reformës në drejtësi, dhe në funksion të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si problematikat kryesore që kanë shqetësuar shoqërinë shqiptare për gati 30 vjet, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 95/2016 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. ('Ligji për SPAK-un)', 2016.

Qëllimi kryesor i këtij ligji ishte të përcaktonte kuadrin ligjor, kompetencat dhe rregullat sipas të cilave do të funksiononin dy organet kryesore që objekt kryesor të tyre do të kishin luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Përkatësisht, Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Njësia e Pavarur Hetimore, si organe kushtetuese, sipas pikës 4, të nenit 148, të Kushtetutës. Në këtë kontekst Prokuroria e Posaçme, konsiderohet një prokurori e specializuar, për të ushtruar kompetencat e parashikuara në pikën 1, të nenit 148/dh, të Kushtetutës, në mënyrë efikase dhe të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm. Prokuroria e Posaçme përbëhet nga drejtuesi i prokurorisë dhe nga prokurorët e posaçëm.

Prokuroria e Posaçme²⁹ ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë. Përbëhet nga të paktën 10 prokurorë, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Ligji vendos kriteret e tjera për përzgjedhjen si dhe për procedurën transparente dhe publike të emërimit. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet nga radhët e prokurorëve të kësaj prokurorie me shumicën e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për 3 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje, sipas ligjit. Prokurori i Prokurorisë së Posaçme shkarkohet për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një shkeljeje të rëndë disiplinore me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Kandidati për prokuror, oficer i hetimit, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, Njesisë së Posaçme Hetimore, si dhe familjarët e afërm të tij, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve personale, sipas ligjit."

Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në përputhje me parashikimet e nenit 148/dh të Kushtetutës dhe legjislacionin në fuqi, për një mandat nëntëvjeçar. Mandati pezullohet apo ndërpritet vetëm nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkon procedim disiplinor kundër prokurorit.

²⁹Ligji Nr. 76/2016 Neni 148/dh

Ndërsa, formimi i Njësisë së Pavarur Hetimore konsiston në hetimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe veprave të tjera penale të kryera vetëm nga subjektet e parashikuara në pikën 2, të nenit 135, të Kushtetutës, të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm.

Byroja Kombëtare e Hetimit³⁰ është strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, që heton veprat penale në juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale. Byroja Kombëtare e Hetimit ka në përbërje të saj hetuesit dhe Shërbimet e Policisë Gjyqësore sipas këtij ligji. Drejtuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, hetuesit dhe shërbimet e Policisë Gjyqësore drejtohen dhe kontrollohen nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme.

Zhvillimet dominante

Vetingu

Kishte vetëm një mënyrë për të ndarë pjesën e kalbur të këtij sistemi nga pjesa e shëndoshë e tij - procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve³¹, i pagëzuar si procesi i vetingut i konsideruar një proces skanimi profesional, moral e pasuror të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve. Megjithëse një proces i panjohur dhe i pazbatuar më parë, arriti të certifikohet si një standard i pranuar ndërkombëtarisht edhe me asistencën e Komisionit të Venecias.

Procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tre kriterëve³²:

- a) vlerësimi i pasurisë;
- b) kontrolli i figurës;
- c) vlerësimi i aftësive profesionale.

Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni (që është Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i parashikuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të Kushtetutës), Kolegji i Apelimit (që është Kolegji i Posaçëm i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, i parashikuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të Kushtetutës,) nga komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9- vjeçar. Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" dhe legjisllacionit që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

³⁰Ligji Nr. 95/2016 Neni 5

³¹Ligji Nr. 84/2016

³²Ligji Nr. 84/2016 Neni

Roli i ndërkombëtarëve

Sikundër konstantohet reforma në drejtësi ka sjellë shume risi të cilat u parashtruan në këtë material. Ajo që mund të konstatohet si risia më e madhe në këtë reformë është përfshirja e një autoriteti ndërkombëtar jo vetëm në reformën në drejtësi, por mbi të gjitha në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Përveç përfshirjes formale rezulton se Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, gjatë kësaj periudhe trevjecare ka ushtruar një rol substancial në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku të gjitha rekomandimet e tij janë adoptuar gjerësisht nga Komisioneri Publik, dhe nga Kolegji i Apelimit.

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM), edhe pse një mekanizëm jo vendimmarrës apo i detyrueshëm, sidoqoftë përbën një instrument që bazat themelore të përgjegjësisë të tij i ka të parashikuara në dispozitat e Aneksit Kushtetues. Në nenin B të këtij aneksi përcaktohet se, ONM do të mbështesë procesin e vettingut nëpërmjet monitorimit dhe mbikëqyrjes së të gjithë procesit. Ky Operacion përfshin partnerët në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe bashkëpunimit euro-atlantik dhe udhëhiqet nga Komisioni Evropian.

Neni B

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit

1. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit do të mbështesë procesin e rivlerësimit nëpërmjet monitorimit dhe mbikëqyrjes së gjithë procesit. Ky Operacion përfshin partnerët në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe bashkëpunimit euro-atlantik dhe udhëhiqet nga Komisioni Evropian.

2. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i ushtron detyrat e veta sipas marrëveshjeve ndërkombëtare. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit emëron vëzhguesit ndërkombëtarë pas njoftimit të Këshillit të Ministrave. Vëzhguesit emërohen nga radhët e gjyqtarëve ose prokurorëve me jo më pak se 15 vjet eksperiencë në sistemin e drejtësisë së vendeve të tyre përkatëse. Mandati i vëzhguesit ndërkombëtar ndërpritet nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit për shkelje të rënda.

3. Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: a) i jep rekomandime Kuvendit lidhur me kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e anëtarit të Komisionit, gjyqtarit të Kolegjit të Apelimit dhe Komisionerit Publik; b) paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga 63 Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 62 Kolegji i Apelimit, si dhe kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit DH. Lidhur me këto gjetje, vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojë që Komisioni ose Kolegji i Apelimit të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, sipas ligjit; c) u jep komisionerëve publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim duke dhënë arsyet e refuzimit; ç) kanë të drejtën të marrin të gjithë informacionet menjëherë, të dhënat për persona dhe dokumentet e nevojshme, me qëllim monitorimin e procesit të rivlerësimit në të gjitha nivelet dhe fazat.

Bibliografia

1. Ligji nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve";
2. Ligji nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";
3. Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve";
4. Ligji nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë";
5. Ligji nr. 98/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; Kuvendi I Republikës së Shqipërisë
6. Ligji nr. 99/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë";
7. Ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë" (Ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.41 datë 16.05.2017 dhe ligjin nr.47/2019)
8. Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 (ndryshuar me ligjin nr.99/2016) (Ndryshuar me ligjin nr. 45/2021) PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
9. Ligji nr. 76/2016 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR
10. Monitorimi i Zbatimit të Reformës në Drejtësi Tiranë, 2019 <https://www.osfa.al/sites/default/files/raport-monitorimi-i-zbatimit-te-reformes-ne-drejttesi.pdf>
11. Reforma në Drejtësi, Modul Trajnimi për Student jo-juristë dhe Aktivistë të Shqipërisë Civile, Konrad Adenauer Stiftung 2018
12. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (e ndryshuar)
13. <https://www.njihreformenedrejttesi.al/sq/klgj/cfare-eshte-klgj>
14. <http://www.reformanedrejttesi.al/pse-nje-reforme-ne-drejttesi>

15. *Organizimi dhe administrimi i gjykatave në Shqipëri: Roli i kryetarëve të gjykatave, kancelarëve dhe asistentëve ligjorë në këndvështrimin e rekomandimeve të SEJ-it dhe në kuadrin e reformës në drejtësi në Shqipëri*
<https://rm.coe.int/final-report-chairs-chancellors-sej-albanian/16809ebbc>

16. *Reforma në sistemin e drejtësisë: Analiza dhe strategjia, Vëllimi I, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë*

17.

<https://www.parlament.al/Files/Informacione/V%C3%ABllimi%20i%20par%C3%AB,%20pjesa%20e%20par%C3%AB.pdf>

18. *Skëndaj, Erida "Vlerat, Kompleksiteti dhe Sfidat e Procesit të Vettingut në Shqipëri",* Revista *Avokatia*
<http://avokatia.al/revista/19-avokatia-33/71-kushtetutshmeri-33>

19. *Paketa e ligjeve të reformës në drejtësi, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Tiranë, 2018*

<http://klgj.al/wp-content/uploads/2019/09/Paketa-e-Ligjeve-t%C3%AB-Reform%C3%ABs-n%C3%AB-Drejt%C3%ABsi-2018.pdf>

20. *Strategjia e reformës në sistemin e drejtësisë, Republika e Shqipërisë, Kuvendi Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Projekt 24 korrik 2015*

